



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 5852 prot.

Tiranë, më 21.5.2026

URDHËR

Nr. 439 datë, 21.5. 2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË MINISTRISË SË
TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT 2026-2030”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 5 të nenit 16 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe vendimit nr. 859, datë 26.12.2024 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës”, si dhe në përputhje me objektivat e reformës në administratën publike dhe të integritetit institucional,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për periudhën 2026-2030, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri të gjitha drejtoritë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
4. Ngarkohet Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
BLENDI GONXHJA



**PLANI INSTITUCIONAL I
INTEGRITETIT
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
2026–2030**

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit e konsideron integritetin jo si një element formal apo dokument të izoluar, por si shtyllën themelore të funksionimit të institucionit, një mënyrë pune dhe një standard në ushtrimin e funksioneve publike. Integriteti përkufizohet si aftësia për të vepruar në përputhje me vlerat themelore të shërbimit publik: ligjshmërinë, ndershmërinë, transparencën, paanshmërinë dhe përgjegjësinë publike.

Në vijim të këtij angazhimi, Ministria ka hartuar Planin institucional të Integritetit, i cili synon të forcojë mekanizmat e brendshëm të kontrollit dhe parandalimit të praktikave të cenueshme nga korrupsioni, konflikti i interesit dhe ndikimi i papërshtatshëm në proceset vendimmarrëse; të përmirësojë transparencën institucionale dhe llogaridhënien ndaj publikut; të rrisë ndërgjegjësimin e punonjësve për përgjegjësitë që mbartin dhe të nxisë një kulturë etike dhe profesionale të orientuar drejt shërbimit publik; të sigurojë që çdo qytetar të trajtohet me barazi, drejtësi dhe respekt, duke garantuar qasje të plotë në shërbimet publike dhe duke minimizuar çdo formë arbitrariteti apo diskriminimi; si dhe të konsolidojë besimin e publikut ndaj institucionit si një strukturë publike funksionale, transparente dhe efikase.

Ministria është e vetëdijshme se lufta kundër korrupsionit nuk është vetëm detyrim ligjor, por mbi të gjitha detyrim moral dhe institucional. Ky detyrim kërkon vullnet të qëndrueshëm, përkushtim të sinqertë dhe bashkëpunim të të gjithë aktorëve: nga drejtuesit më të lartë te çdo nëpunës publik. Çdo punonjës i MTKS është një hallkë kyçe në këtë zinxhir përgjegjësie. Ai nuk është thjesht zbatues i detyrave, por garantues i integritetit institucional në çdo veprim që ndërmerr.

MTKS është një ministri e krijuar së fundmi dhe ndodhet në fazë konsolidimi institucional. Kjo fazë e hershme është vendimtare për vendosjen e standardeve të qarta të sjelljes, disiplinës procedurale, kontrollit të brendshëm dhe transparencës. Për këtë arsye, ky plan nuk trajtohet si dokument deklarativ, por si instrument pune, i cili shoqëron ndërtimin e rregullave të brendshme, qartësimin e roleve, standardizimin e procedurave dhe krijimin e një klime organizative të bazuar në meritë, respekt, llogaridhënie dhe shërbim cilësor ndaj qytetarit.

MINISTËR

Blendi Gonxhja

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	5
2. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PLANIT	6
3. PARIMET UDHËHEQËSE TË INTEGRITETIT NË MTKS.....	6
4. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT DHE ORGANIZIMI I PUNËS	6
5. QASJA METODOLOGJIKE E VLERËSIMIT TË RISKUT	7
6. BAZA LIGJORE DHE MATERIALET REFERUESE	7
7.VLERËSIMI I RISQEVE TË INTEGRITETIT	7
8. ANALIZA E OBJEKTIVAVE TË PLANIT.....	8
8.1 Transparenca dhe monitorimi i vazhdueshëm	8
8.2 Burime njerëzore të kualifikuara dhe etikë funksionale	8
8.3 Kuadër rregullator i brendshëm dhe disiplinë procedurale.....	8
9. RISQET E PËRGJITHSHME NDËRSEKTORIALE	8
9.1 E drejta e informimit	8
9.2 Konflikti i interesit.....	8
9.3 Ndikimi i papërshtatshëm dhe presionet jashtëinstitucionale.....	9
9.4 Digjitalizimi dhe varësia nga sistemet online.....	9
10. ANALIZA E RISQEVE SIPAS FUSHAVE / DREJTORIVE.....	9
10.1 TURIZMI – DREJTORIA E STANDARDEVE TË TURIZMIT.....	9
10.1.1 Konteksti dhe objektivat e fushës	9
10.1.2 Risqet kryesore të integritetit	9
10.1.3 Masat e menaxhimit të riskut	10
10.2 TRASHËGIMIA KULTURORE & MUZETË – STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE INSTITUCIONET E VARËSISË.....	10
10.2.1 Qëllimi dhe rëndësia.....	10
10.2.2 Risqet kryesore	11
10.2.3 Masat parandaluese	12

10.3 SPORTI – SPORTI ELITAR DHE GJITHËPËRFSHIRËS	12
10.3.1 Qëllimi dhe rëndësia	12
10.3.2 Risqet kryesore	13
10.3.3 Masat parandaluese	14
10.4 ARTI/KULTURA & PROJEKTET BE/IPA – (DPAK) KOORDINIMI DHE RAPORTIMI	15
10.4.1 Konteksti	15
10.4.2 Risqet kryesore	15
10.4.3 Masa të propozuara	16
10.5 PROKURIMET – DREJTORIA E PROKURIMEVE	17
10.5.1 Qëllimi dhe fusha	17
10.5.2 Risqet kryesore	18
10.5.3 Masat operacionale	18
10.6 RINIA – PROGRAMET, FINANCIMET, PJESËMARRJA, BASHKËPUNIMI	19
10.6.1 Konteksti	19
10.6.2 Risqet kryesore	19
10.6.3 Masat parandaluese	20
11. MASA PARANDALUESE DHE KORRIGJUESE	21
12. STRUKTURA E MONITORIMIT, RAPORTIMIT DHE PËRDITËSIMIT	22
13. ANEKS – PLAN MASASH	22

1. HYRJE

Integriteti institucional përbën një nga themelet kryesore të qeverisjes së mirë dhe një parakusht për funksionimin e rregullt, të ligjshëm dhe efektiv të administratës publike. Ai shprehet në mënyrën se si ndërtohen dhe zbatohen politikat, si administrohen burimet publike, si merren vendimet dhe si garantohet që çdo proces të udhëhiqet nga interesi publik, profesionalizmi dhe përgjegjshmëria. Për MTKS, integriteti nuk konsiderohet vetëm si standard i sjelljes individuale, por si mekanizëm institucional që mbështet punën e përditshme, rrit cilësinë e shërbimit dhe forcon besimin e publikut.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit është një institucion i krijuar së fundmi, në një fazë ku konsolidimi i strukturave, unifikimi i praktikave administrative dhe ndërtimi i një kulture të qartë organizative janë procese vendimtare për performancën e saj afatgjatë. Kjo periudhë përbën një mundësi strategjike për të vendosur standarde të qëndrueshme integriteti që në fillim: rregulla të qarta të funksionimit, procedura të standardizuara, ndarje të përcaktuara përgjegjësish dhe instrumente të kontrollit të brendshëm, të cilat minimizojnë arbitraritetin, rrisin transparencën dhe e bëjnë vendimmarrjen të verifikueshme.

Fushat e përgjegjësive të MTKS – turizmi, kultura, trashëgimia kulturore dhe muzetë, sporti dhe rinia – karakterizohen nga ndërveprim i gjerë me aktorë publikë e privatë, menaxhim programesh dhe projektsh, përdorim fondesh publike, procese certifikimi/standardizimi, si edhe vendimmarrje me ndikim ekonomik, social dhe reputacional. Pikërisht për këtë arsye, ngritja e një sistemi të qartë për identifikimin, parandalimin dhe adresimin e risqeve të integritetit është një komponent i domosdoshëm i qeverisjes institucionale dhe i arritjes së rezultateve në shërbim të qytetarëve.

Ky Plan Institucional i Integritetit paraqet qasjen e MTKS për të ndërtuar dhe zbatuar masa parandaluese e korrigjuese, për të forcuar kontrollin e brendshëm, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të nxitur një kulturë etike dhe profesionale në të gjitha nivelet e institucionit. Plani shërben si dokument udhëzues për organizimin e veprimtarisë, si instrument monitorimi për drejtuesit dhe si garanci publike se MTKS është e angazhuar të veprojë me integritet, korrektësi dhe përgjegjësi në çdo funksion të saj.

Në këtë kuadër, integriteti trajtohet si pjesë e performancës institucionale: një standard që rrit besueshmërinë, përmirëson menaxhimin e burimeve dhe siguron që çdo vendim dhe çdo proces të mbështetet në ligj, në rregulla të qarta dhe në parimin e trajtimit të barabartë.

2. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I PLANIT

Qëllimi i Planit të Integritetit të MTKS është të mundësojë një vlerësim të strukturuar, të bazuar në evidenca, të risqeve të integritetit që mund të ndikojnë në aftësinë e institucionit për të përmbushur misionin dhe funksionet e tij në mënyrë të ligjshme, të paanshme, të përgjegjshme dhe transparente.

Plani zbatohet në të gjitha njësitë organizative të MTKS, si dhe shtrihet në marrëdhëniet dhe proceset e koordinimit me institucionet e varësisë. Duke qenë se ministria është e re, plani merr parasysh nevojën për të harmonizuar praktikrat që mund të jenë trashëguar nga struktura të mëparshme, duke i vendosur ato në standarde të unifikuara.

3. PARIMET UDHËHEQËSE TË INTEGRITETIT NË MTKS

Integriteti i MTKS ndërtohet mbi këto parime:

- parimin e ligjshmërisë si themel i çdo veprimi administrativ;
- mbi parimin e transparencës si kusht për llogaridhënie;
- mbi paanshmërinë si garanci e trajtimit të barabartë;
- mbi profesionalizmin si standard i cilësisë;
- dhe mbi përgjegjësinë publike si detyrim për të justifikuar vendimmarrjen dhe përdorimin e burimeve.

Në praktikë, këto parime përkthehen në: dokumentim të plotë të vendimeve, ndarje të qartë të roleve, shmangie të konfliktit të interesit, procedura të standardizuara, akses të qytetarëve në informacion dhe mekanizma raportimi e korrigjimi kur ndodhin devijime.

4. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT DHE ORGANIZIMI I PUNËS

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit me urdhrin nr.267, datë 02.12.2025 , ka ngritur grupin e punës “Për hartimin e Planit të Integritetit për ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit 2026-2030”.

Hartimi i Planit të Integritetit është kryer nga Grupi i Punës, i cili kishte në përbërje të tij anëtarë të nivelit drejtues, përgjegjës sektori si dhe specialist të drejtorive të ndryshme të institucionit. analizoi kuadrin ligjor, dokumentet e brendshme ekzistuese, praktikrat e punës dhe pikat e ndërveprimit me publikun dhe subjektet e jashtme. Gjatë këtij procesi, janë angazhuar dhe kanë kontribuar të gjitha strukturat e brendshme të Ministrisë, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

5. QASJA METODOLOGJIKE E VLERËSIMIT TË RISKUT

Gjatë kësaj faze, është kryer identifikimi i risqeve dhe faktorëve të tyre. Me qëllim identifikimin e risqeve dhe faktorëve të tyre, grupi i punës ka kryer një analizë të detajuar duke u koordinuar edhe me drejtoritë e tjera të institucionit. Kuadri i brendshëm rregullator, raportimet e ndryshme bazuar në veprimtarinë e drejtorive të institucionit janë të dhënat kryesore për këtë fazë. Mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, identifikimi i risqeve është realizuar kryesisht në fushën e: a) menaxhimit financiar; b) burimeve njerëzore; c) transparencës; d) konsultimit publik; dh) informimit; e) etikës, si dhe fusha të tjera të veprimtarisë së institucionit.

6. BAZA LIGJORE DHE MATERIALET REFERUESE

Baza ligjore dhe materialet referuese mbi të cilat mbështetet hartimi dhe zbatimi i këtij Plani përfshijnë legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, etikën dhe integritetin në administratën publike, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrisë përgjegjëse për kulturën. Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligji nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Vendimi nr. 516, datë 01.07.2020 i Këshillit të Ministrave, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2023 dhe planit të veprimit përkatës, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.09.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”, si dhe Urdhri nr. 334, datë 7.10.2020 i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”.

7. VLERËSIMI I RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në MTKS, proceset më tipike ku krijohet cënueshmëri integriteti janë:

- a) proceset e planifikimit strategjik dhe hartimit të politikave (rrezik ndikimi i papërshtatshëm, konsultim jo i plotë, “policy capture”);
- b) proceset e certifikimit, kategorizimit dhe standardizimit (rrezik favorizimi, devijim kriteresh);
- c) proceset e financimeve, granteve dhe mbështetjes me fonde (rrezik përzgjedhje jo e paanshme, monitorim i dobët i zbatimit);
- d) prokurimet publike dhe menaxhimi i kontratave (rrezik konflikt interesi, devijim kriteresh, ndërhyrje);
- e) projektet me donatorë/BE (rrezik koordinim i dobët, raportim jo standard, mbivendosje rolesh);

- f) menaxhimi i të dhënave, informimit dhe transparencës (rrezik vonesash, publikim jo i plotë, mosrespektim afatesh).

8. ANALIZA E OBJEKTIVAVE TË PLANIT

8.1 Transparenca dhe monitorimi i vazhdueshëm

Transparenca në MTKS nuk lidhet vetëm me publikimin formal të informacionit, por me ndërtimin e një sistemi ku vendimmarrja është e kuptueshme dhe e verifikueshme. Publiku duhet të ketë mundësi të shohë kriteret, procedurat, vendimet, rezultatet dhe mënyrën se si monitorohet zbatimi. Për një ministri të re, kjo do të thotë edhe ndërtim i rubrikave të qarta në faqen zyrtare, standardizim i njoftimeve, regjistrave, raporteve dhe vendimeve.

8.2 Burime njerëzore të kualifikuara dhe etikë funksionale

Burimet njerëzore dhe kultura e brendshme janë “pika e parë e mbrojtjes” së integritetit. MTKS synon të konsolidojë praktika të rekrutimit dhe vlerësimit mbi meritën, trajnimet e vazhdueshme mbi etikën dhe konfliktin e interesit, si dhe një mekanizëm funksional të këshillimit etik nga njësia përkatëse.

8.3 Kuadër rregullator i brendshëm dhe disiplinë procedurale

Në mungesë të procedurave të shkruara, rritet arbitrariteti. Prandaj, MTKS do të zhvillojë manuale dhe udhëzime të brendshme për proceset më të ndjeshme: komisionet, prokurimet, monitorimet, thirrjet e financimit, raportimin e projekteve, si dhe protokolle komunikimi ndërmjet drejtorive.

9. RISQET E PËRGJITHSHME NDËRSEKTORIALE

9.1 E drejta e informimit

MTKS përfaqësohet nga Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, i cili siguron aksesin në informacion publik, administron regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe koordinon brenda strukturave për kthimin e përgjigjeve brenda afateve. Risku kryesor lidhet me kërkesa që prekin informacion të kufizuar ligjërisht, si dhe me ngarkesat që mund të sjellin vonesa. Kjo kërkon standardizim të procesit të brendshëm, ndarje përgjegjësish dhe një “rrugë të shkurtër” koordinimi me drejtorinë.

9.2 Konflikti i interesit

Në një ministri me procese të shumta komisionesh, financimesh, certifikimesh dhe prokurimesh, konflikti i interesit është risk konstant. MTKS do të zbatojë deklarin e detyrueshëm,

përfashtimin nga vendimmarrja në rast konflikti dhe këshillimin e stafit për rastet e dyshimta. Përveç kësaj, do të forcohet kultura e “parandalimit” – pra identifikimi i hershëm para se të ndodhë vendimmarrja.

9.3 Ndikimi i papërshtatshëm dhe presionet jashtëinstitucionale

Në sektorët e turizmit, kulturës, rinisë dhe sportit ekziston një nivel i lartë ndërveprimi ndërmjet institucioneve publike, aktorëve privatë dhe grupeve të interesit, çka krijon potencial për ushtrimin e ndikimeve të papërshtatshme mbi proceset vendimmarrëse, kriteret e përzgjedhjes, shpërndarjen e fondeve apo afatet procedurale. Për të minimizuar këto risqe, është e nevojshme të garantohen procedura të standardizuara, vendimmarrje kolegjiale dhe e dokumentuar, transparencë në administrimin e proceseve, si dhe mekanizma të qartë kontrolli dhe auditueshmërie, në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe besueshmëria e vendimmarrjes publike.

9.4 Digjitalizimi dhe varësia nga sistemet online

Mosfunksionimi i sistemeve online apo pamundësia e aksesit krijon risk operacional dhe risk integriteti (sepse procedurat mund të bëhen “me rrugë alternative” pa standard). MTKS do të parashikojë procedura alternative të dokumentuara dhe koordinim të ngushtë me AKSHI për vazhdimësi shërbimi.

10. ANALIZA E RISQEVË SIPAS FUSHAVE / DREJTORIVE

10.1 TURIZMI – DREJTORIA E STANDARDEVE TË TURIZMIT

10.1.1 Konteksti dhe objektivat e fushës

Drejtorja e Standardeve të Turizmit ka rol kyç në standardizimin dhe monitorimin e veprimtarive turistike, si dhe në procese që lidhen me projekte strategjike dhe zona me përparësi zhvillimi, certifikime (p.sh. agroturizmi), kategorizime/klasifikime të strukturave akomoduese, si dhe në monitorimin e “Marrëveshjeve të Zhvillimit” me subjekte që kanë status investitori në struktura 4/5 yje me status special. Po kështu, nëpërmjet koordinimit të sezonit turistik dhe strukturave të menaxhimit, drejtorja ndikon në funksionimin e gjithë sektorit dhe ndërvepron me shumë aktorë publikë e privatë.

10.1.2 Risqet kryesore të integritetit

Një risk i rëndësishëm lidhet me planifikimin dhe hartimin e politikave të turizmit. Nëse procesi i hartimit nuk është i strukturuar, nuk mbështetet në analiza objektive dhe nuk shoqërohet me konsultim publik real, ekziston rreziku që politikat të ndikohen nga interesa të ngushta, të krijojnë avantazhe të padrejta ose të mos i përgjigjen nevojave reale të sektorit. Ky risk shfaqet edhe kur transparenca gjatë hartimit është e pjesshme, ose kur dokumentet bazë nuk publikohen dhe nuk dokumentohet se si janë marrë parasysh komentet.

Një tjetër risk lidhet me ndikimin e tepruar të aktorëve privatë në politikbërje dhe vendimmarrje. Në turizëm, interesat private janë të forta dhe shpesh të mirë-organizuara. Kur mungon disiplinë e fortë e takimeve, e dokumentimit dhe e konfliktit të interesit, krijohen hapësira për lobim të papërshtatshëm, presion ndaj administratës dhe “kapje” të vendimeve. Në rastet më problematike, kjo mund të prodhojë risk reputacional për ministrinë dhe risk ligjor për shkelje etike.

Risk operacional shfaqet në monitorimin e Marrëveshjeve të Zhvillimit, veçanërisht kur ka afate të zgjatura, raportim të dobët, mosdorëzim dokumentacioni periodik ose mungesë standardi se si trajtohen devijimet. Mungesa e një sistemi monitorimi të strukturuar e bën të vështirë të ndahen rastet e vonesave legjitime nga rastet e abuzimit apo mosrespektimit. Për një ministri të re, rreziku rritet edhe nga nevoja për të unifikuar praktikatat e ndjekjes.

Një risk tjetër i rëndësishëm është varësia nga sistemet online (e-albania, e-lejet, sisteme të tjera), ku mosfunksionimi krijon vonesa dhe rrit mundësinë e “rrugëve alternative” jo të standardizuara. Nëse alternativa nuk është e dokumentuar, mund të krijohen trajtime të ndryshme për subjekte të ndryshme, pra risk integriteti.

10.1.3 Masat e menaxhimit të riskut

MTKS do të forcojë dokumentimin e procesit të politikbërjes dhe konsultimit publik, duke standardizuar hapat: publikim paraprak, afate, përmbledhje e komenteve, arsyetim për pranimin/refuzimin dhe publikim përfundimtar. Për të ulur riskun e ndikimit privat, do të forcohet rregulli i transparencës së takimeve zyrtare dhe dokumentimit të komunikimeve, si dhe do të bëhet më i fortë filtrimi i konfliktit të interesit në komisione dhe grupe pune.

Për Marrëveshjet e Zhvillimit do të ndërtohet një model monitorimi me kontrole periodike, kërkesa standarde dokumentacioni, sinjalizim të hershëm për devijime dhe një procedurë të qartë të ndërhyrjes administrative. Do të përforcohet koordinimi me strukturat juridike për rishikim të përcaktimeve ku ka boshllëqe.

Për sistemet online do të parashikohen procedura alternative të miratuara dhe të dokumentuara, të cilat aktivizohen vetëm në rastet e mosfunksionimit të sistemit, duke ruajtur gjurmueshmërinë dhe barazinë e trajtimit.

10.2 TRASHËGIMIA KULTURORE & MUZETË – STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE INSTITUCIONET E VARËSISË

10.2.1 Qëllimi dhe rëndësia

Trashëgimia kulturore materiale dhe jomateriale, administrimi i muzeve, si dhe proceset që lidhen me identifikimin, restaurimin, konservimin, inventarizimin dhe promovimin e pasurive kulturore përfaqësojnë një fushë me interes publik dhe ndjeshmëri të lartë institucionale. Vendimmarrja në këtë sektor ka ndikim afatgjatë në ruajtjen e identitetit kombëtar, memorien historike dhe besimin

e publikut ndaj institucioneve shtetërore përgjegjëse për kulturën dhe trashëgiminë kulturore. Rreziqet e integritetit në këtë fushë nuk lidhen vetëm me administrimin e fondeve publike, por edhe me autenticitetin e ndërhyrjeve, profesionalizmin teknik, përzgjedhjen e projekteve prioritare, administrimin e koleksioneve muzeale dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të konservimit dhe restaurimit. Risku mund të shfaqet në formën e ndikimeve të papërshtatshme në proceset e përzgjedhjes së projekteve, mungesës së dokumentimit të plotë teknik, ndërhyrjeve jo profesionale mbi objektet e trashëgimisë kulturore, konfliktit të interesit në procedurat e ekspertimit apo mungesës së gjurmueshmërisë në administrimin dhe lëvizjen e pasurive kulturore.

Në këtë kuadër, forcimi i integritetit institucional kërkon procedura të standardizuara dhe të dokumentuara, vendimmarrje të bazuar në ekspertizë profesionale, ndarje të qartë të përgjegjësisë administrative dhe teknike, si dhe mekanizma efektivë kontrolli, monitorimi dhe auditimi. Gjithashtu, është e nevojshme të garantohet transparenca në administrimin e fondeve, inventarizimin dhe menaxhimin e koleksioneve muzeale, si dhe zbatimi i standardeve profesionale në çdo ndërhyrje që prek pasuritë kulturore materiale dhe jomateriale.

10.2.2 Risqet kryesore

Një risk thelbësor lidhet me konfliktin e interesit në proceset e vendimmarrjes që kanë të bëjnë me projektet e restaurimit, ndërhyrjet në pasuritë kulturore, shpërndarjen e fondeve publike, procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të licencuara apo ekspertëve të përfshirë në këto procese. Në mungesë të mekanizmave efektivë të kontrollit të brendshëm, dokumentimit të plotë administrativ dhe gjurmueshmërisë së vendimmarrjes, krijohen hapësira për favorizime, ndikime të papërshtatshme ose ndërhyrje jo profesionale, të cilat mund të cenojnë integritetin institucional dhe besueshmërinë publike. Një tjetër risk lidhet me ndërhyrjet e paautorizuara ose të pamonitoruara profesionalisht në pasuritë kulturore materiale dhe objektet muzeore. Këto ndërhyrje mund të cenojnë autenticitetin, integritetin historik dhe vlerat kulturore të monumenteve dhe objekteve të trashëgimisë, duke shkaktuar pasoja të pakthyeshme për ruajtjen e tyre. Në të njëjtën kohë, raste të tilla krijojnë dëm reputacional për institucionet përgjegjëse dhe dobësojnë besimin e publikut në kapacitetin e administratës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Po ashtu, ekziston rreziku i humbjes, dëmtimit, zhvendosjes së paautorizuar ose administrimit jo të duhur të pasurive kulturore dhe koleksioneve muzeore, veçanërisht në rastet kur mungojnë standarde të unifikuara të sigurisë fizike, procedura të qarta inventarizimi dhe sisteme të plota dokumentimi dhe gjurmueshmërie. Ky risk bëhet më i lartë në kushtet e administrimit të decentralizuar të koleksioneve dhe nivelit të ndryshëm të kapaciteteve administrative dhe teknike ndërmjet institucioneve të varësisë.

Rreziku në administrimin e fondeve publike shfaqet gjithashtu në rastet kur projektet e restaurimit, konservimit apo promovimit kulturor nuk prioritetizohen mbi bazën e analizës së riskut, rëndësisë kulturore dhe nevojave reale të ndërhyrjes, por ndikohen nga faktorë jo profesionalë ose nga mungesa e planifikimit strategjik. Në kushtet e një strukture institucionale të re dhe të integruar,

sfidë mbetet edhe koordinimi efektiv ndërmjet ministrisë dhe institucioneve të varësisë, si dhe nevoja për standardizimin e procedurave, raportimit administrativ dhe monitorimit të proceseve në të gjithë sektorin.

10.2.3 Masat parandaluese

MTKS do të vijojë plotësimin dhe përditësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, me qëllim standardizimin e procedurave administrative, teknike dhe vendimmarrëse, si dhe ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësi ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe institucioneve të varësisë. Në këtë kuadër, do të forcohet dokumentimi administrativ dhe gjurmueshmëria e proceseve që lidhen me restaurimin, konservimin, inventarizimin, administrimin dhe lëvizjen e pasurive kulturore. Digjitalizimi i dokumentacionit, inventarizimi dhe katalogimi elektronik i pasurive kulturore dhe koleksioneve muzeore do të trajtohen si masa të rëndësishme integriteti institucional, pasi rrisin transparencën, gjurmueshmërinë dhe kontrollin administrativ, si dhe reduktojnë rrezikun e manipulimit, humbjes ose administrimit jo të rregullt të informacionit dhe objekteve kulturore.

Për ndërhyrjet restauruese dhe konservuese do të forcohen mekanizmat e mbikëqyrjes profesionale, kontrollit teknik dhe auditueshmërisë së proceseve, përfshirë verifikimin e dokumentacionit teknik, monitorimin periodik të zbatimit të projekteve dhe administrimin e listave të subjekteve dhe ekspertëve të licencuar. Gjithashtu, do të nxitet përdorimi i standardeve profesionale dhe procedurave të unifikuara për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale. Në sektorin muzeor do të forcohen standardet e sigurisë fizike dhe administrative për koleksionet dhe objektet muzeore, si dhe do të kërkohet raportim më i strukturuar dhe periodik mbi inventarët, lëvizjet, huazimet, ekspozimet dhe kushtet e ruajtjes së objekteve. Krahas kësaj, do të përmirësohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm, raportimit dhe monitorimit për të garantuar integritetin e administrimit të pasurive kulturore dhe përdorimin e rregullt të fondeve publike në këtë sektor.

10.3 SPORTI – SPORTI ELITAR DHE GJITHËPËRFSHIRËS

10.3.1 Qëllimi dhe rëndësia

Sporti është fushë ku integriteti lidhet me financimin publik, përzgjedhjen dhe garat e ndershme, mbrojtjen e sportistëve dhe të të miturve, si dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare (anti-doping, qeverisje e mirë sportive). Për shkak të interesit publik dhe emotiv, risku reputacional është i lartë. Politikat shtetërore në fushën e sportit synojnë garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së të drejtave të shtetasve që angazhohen në edukim fizik dhe sport, në përputhje me Karta Evropiane e Sportit dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare përkatëse. Këto politika kanë për qëllim përmirësimin dhe zbatimin e standardeve për sportin elitare dhe sportin në institucionet arsimore, si në aspektin organizativ, teknik dhe funksional, në nivel qendror dhe vendor.

Nëpërmjet këtyre politikave synohet krijimi i mundësive të barabarta dhe kushteve të përshtatshme për pjesëmarrjen e të gjithë shtetasve në aktivitete sportive, duke respektuar të drejtën themelore për ushtrimin e aktivitetit fizik dhe sportiv. Për këtë arsye, parashikohet ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ligjore, financiare dhe fizike, si dhe forcimi i marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe institucioneve sportive. Një rëndësi e veçantë i kushtohet zhvillimit, ristrukturimit dhe rindërtimit të infrastrukturës sportive në nivel qendror, vendor dhe në institucionet arsimore publike, me qëllim masivizimin e sportit dhe rritjen e cilësisë së tij në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, politikat synojnë parandalimin e korrupsionit, abuzimit me detyrën, nepotizmit, dopingut dhe manipulimit të garave sportive, duke promovuar integritetin dhe ndershmërinë në çdo nivel të aktivitetit sportiv.

Në këtë kuadër, synohet rritja e transparencës në përdorimin e fondeve publike, në zbatimin e programeve sportive dhe në realizimin e investimeve infrastrukturore. Njëkohësisht, rëndësi i jepet forcimit të etikës profesionale në sportin elitare dhe atë gjithëpërfshirës, si dhe mbrojtjes së sportistëve, trajnerëve, gjyqtarëve, fëmijëve dhe grupeve vulnerabël. Politikat shtetërore synojnë gjithashtu përmirësimin e menaxhimit të garave sportive dhe të proceseve të përzgjedhjes e kualifikimit në ekipet kombëtare, përmes krijimit të mekanizmave efektivë të raportimit, kontrollit të brendshëm dhe masave të qarta disiplinore. Në tërësi, këto politika kanë për objektiva krijimin e një mjedisi sportiv të drejtë, etik, të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë pjesëmarrësit në sport.

10.3.2 Risqet kryesore

Në administrimin institucional, risku shfaqet kur vendimmarrja ndikohet nga konflikt interesi, ndikime politike apo ndërhyrje jo profesionale, ose kur mungon dokumentimi i qartë i kriterit dhe procesit. Në menaxhimin financiar, risku kryesor është keqpërdorimi i fondeve publike, favorizimet në grante/projekte dhe dobësia e kontrollit të brendshëm në investime. Identifikimi i fushave me rrezik të lartë për integritetin përbën një element të rëndësishëm në garantimin e funksionimit të drejtë, transparent dhe profesional të institucioneve sportive dhe aktiviteteve që lidhen me sportin. Në administrimin institucional, rreziqet kryesore lidhen me konfliktin e interesit në proceset vendimmarrëse, ndikimet politike apo ndërhyrjet joprofesionale, si dhe mungesën e dokumentimit dhe procedurave transparente, të cilat mund të cenojnë besueshmërinë dhe eficiencën institucionale. Në fushën e menaxhimit financiar evidentohen rreziqe që lidhen me keqpërdorimin e fondeve publike, humbjen e fondeve dhe abuzimet në procedurat e prokurimit publik, si edhe favorizimet në shpërndarjen e projekteve sportive dhe granteve. Këto praktika ndikojnë negativisht në barazinë, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit sportiv. Në sportin elitare, ndër sfidat kryesore për integritetin konsiderohen manipulimi i rezultateve të ndeshjeve dhe përdorimi i substancave të ndaluara apo praktikave të dopingut, të cilat dëmtojnë ndershmërinë sportive dhe imazhin e institucioneve sportive në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga ana tjetër, risku lidhet edhe me integritetin e garave, manipulimin e rezultateve dhe çështjet e dopingut. Në sportin gjithëpërfshirës dhe bazë, risku lidhet me sigurinë e fëmijëve, mundësinë e abuzimit nga figura autoriteti (trajnerë etj.) dhe mungesën e transparencës në aktivitetet

komunitare. Ndërkohë, në sportin gjithëpërfshirës dhe atë bazë, rreziqet lidhen me mungesën e mbikëqyrjes për garantimin e mjediseve të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë, mundësinë e abuzimeve nga trajnerët apo persona të tjerë përgjegjës, si dhe nivelin e ulët të transparencës në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve komunitare sportive. Përballimi i këtyre rreziqeve kërkon forcimin e mekanizmave të kontrollit, monitorimit dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizimit sportiv.

10.3.3 Masat parandaluese

MTKS do të synojë standardizimin e kriterëve të përzgjedhjes dhe financimit, duke ndërtuar protokolle të matshme, vendimmarrje të dokumentuar dhe regjistra transparentë të financimeve. Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare Anti-Doping do të jetë i strukturuar dhe periodik, me raportim të qartë për testimet dhe masat. Do të forcohet raportimi financiar publik, si dhe regjistri publik i federatave/klubeve dhe financimeve ku është e mundur ligjrisht. Po ashtu do të ngrihen mekanizma raportimi/sinjalizimi për parregullsi dhe do të forcohen masat për mjedise të sigurta për fëmijët, duke përcaktuar standarde për aktivitetet komunitare dhe sportin në shkolla. Masat parandaluese synojnë forcimin e integritetit, transparencës dhe funksionimit të qëndrueshëm të sistemit sportiv në të gjitha nivelet e organizimit dhe administrimit të tij. Në nivel institucional, parashikohet reformimi i organeve konsultative të Këshilli i Lartë i Sportit dhe përcaktimi i një përbërjeje jopolitike të tyre, me qëllim krijimin e një partneriteti më të fortë ndërinstucional dhe garantimin e pavarësisë profesionale në vendimmarrje. Gjithashtu, synohet riorganizimi dhe fuqizimi i kompetencave të Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, si një mekanizëm i rëndësishëm për sigurimin e stabilitetit dhe zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjeve ndërmjet organizatave sportive. Një tjetër masë e rëndësishme është krijimi i një sistemi elektronik për dokumentimin e proceseve administrative, përfshirë përzgjedhjet, shpërndarjen e fondeve dhe vlerësimin e granteve, me qëllim rritjen e gjurmueshmërisë dhe transparencës institucionale. Në sportin elitare, masat parandaluese fokusohen në garantimin e integritetit të garave dhe proceseve të përzgjedhjes së sportistëve. Për këtë arsye, parashikohet hartimi i një protokollit kombëtar për përzgjedhjen e sportistëve mbi bazën e kriterëve të matshme dhe objektive, si dhe ndalimi i çdo ndikimi politik, financiar apo personal në këto procese. Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, synohet krijimi i një regjistri transparent për rezultatet, analizat dhe performancat sportive. Po ashtu, parashikohet bashkëpunim i plotë me Agjencinë Kombëtare Anti-Doping për parandalimin dhe luftimin e përdorimit të substancave të ndaluara në sport. Në fushën e kontraktimit dhe shpërblimeve, masat synojnë krijimin e procedurave të qarta dhe transparente për shpërndarjen e shpërblimeve, bursave dhe bonuseve për sportistët dhe strukturat sportive, si dhe zhvillimin e inspektimeve periodike mbi dokumentacionin ligjor të federatave sportive për të garantuar respektimin e standardeve dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Në sportin gjithëpërfshirës, vëmendje e veçantë i kushtohet garantimit të qasjes së barabartë për të gjithë qytetarët. Në këtë kuadër, synohet hartimi i standardeve kombëtare për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet sportive, mbështetja financiare specifike për sportin

e grave dhe vajzave, si dhe heqja e barrierave urbane në infrastrukturën sportive. Gjithashtu, rëndësi i kushtohet përfshirjes së komuniteteve përmes programeve si “Sport për të Gjithë” dhe “Sport në Shkollë”, të cilat synojnë masivizimin e sportit dhe promovimin e një jetese aktive. Ndërsa, për të parandaluar praktikën abuzive, parashikohet edhe mbikëqyrja periodike e aktiviteteve komunitare sportive. Në drejtim të transparencës dhe komunikimit publik, masat përfshijnë publikimin periodik të raporteve financiare mbi investimet në sport, krijimin e një regjistri publik për federatat, klubet sportive dhe financimet përkatëse, si dhe ngritjen e një platforme online për raportimin e parregullsive dhe garantimin e aksesit të lirë në dokumentet me interes publik. Këto masa synojnë rritjen e besimit publik dhe forcimin e kulturës së llogaridhënies në sektorin sportiv.

10.4 ARTI/KULTURA & PROJEKTET BE/IPA – (DPAK) KOORDINIMI DHE RAPORTIMI

10.4.1 Konteksti

Në kuadër të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, programet IPA dhe donatorët ndërkombëtarë, integriteti institucional lidhet ngushtë me koordinimin efektiv ndërinstitucional, menaxhimin administrativ dhe financiar të projekteve, si dhe respektimin e procedurave, standardeve dhe kërkesave të përcaktuara nga donatorët. Për shkak të kompleksitetit të proceseve të raportimit, monitorimit dhe zbatimit të projekteve, ekziston rreziku i mospërputhjeve administrative, dokumentimit jo të plotë, vonësive në raportim, mungesës së gjurmueshmërisë së vendimmarrjes apo mosrespektimit të manualeve dhe procedurave të financimit të BE-së dhe donatorëve të tjerë. Në të njëjtën kohë, koordinimi ndërmjet strukturave të ministrisë, institucioneve të varësisë dhe partnerëve zbatues paraqet sfida të vazhdueshme në drejtim të unifikimit të praktikave administrative dhe shkëmbimit të informacionit. Në këtë kontekst, forcimi i mekanizmave të koordinimit, dokumentimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm konsiderohet element thelbësor për garantimin e integritetit institucional, transparencës dhe përdorimit të rregullt të fondeve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorët ndërkombëtarë.

10.4.2 Risqet kryesore

Një risk i identifikuar lidhet me mungesën e koordinimit efektiv ndërinstitucional dhe me partnerët zbatues në proceset e planifikimit, drejtimit, monitorimit dhe raportimit të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe programet IPA. Ky risk bëhet më i lartë në rastet kur nuk janë të përcaktuara qartë hierarkitë administrative, linjat e komunikimit dhe përgjegjësitë funksionale ndërmjet strukturave të ministrisë, institucioneve të varësisë dhe partnerëve të jashtëm. Në mungesë të mekanizmave të standardizuar të koordinimit, krijohen paqartësi lidhur me proceset e raportimit, përgjegjësitë për ndjekjen e aktiviteteve dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit,

duke ndikuar në efikasitetin dhe gjurmueshmërinë e zbatimit të projekteve. Një tjetër risk lidhet me nivelin e pamjaftueshëm të njohurive dhe kapaciteteve të stafit mbi manualin, procedurat financiare, standardet e komunikimit dhe kërkesat e raportimit të Bashkimit Evropian dhe donatorëve ndërkombëtarë. Mungesa e ekspertizës së specializuar mund të sjellë raportim jo të plotë ose jo në kohë, mospërputhje dokumentacioni, mangësi në administrimin financiar dhe mosrespektim të kërkesave procedurale të donatorëve, duke rritur rrezikun e pezullimit të fondeve, korrigjimeve financiare apo dëmtimit të reputacionit institucional. Risk operacional paraqet edhe struktura organizative joefikase në administrimin dhe monitorimin e projekteve IPA, veçanërisht në rastet e mungesës së stafit të dedikuar, vakancave të zgjatura, mbivendosjes së funksioneve ose ngarkesës së lartë administrative mbi një numër të kufizuar punonjësish. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në cilësinë e monitorimit, ndjekjen e afateve kontraktuale, koordinimin me partnerët dhe dokumentimin e aktiviteteve të projektit. Në të njëjtën kohë, mungesa e vazhdimësisë institucionale dhe rotacioni i lartë i stafit krijojnë risk për humbje të memorjes institucionale dhe dobësim të kapaciteteve administrative në menaxhimin e fondeve të BE-së. Gjithashtu, ekziston rreziku i mungesës së sistemeve të integruara të dokumentimit dhe arkivimit të informacionit të projekteve, çka mund të vështirësojë gjurmueshmërinë e vendimmarrjes, kontrollin administrativ dhe auditimin e proceseve nga strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare të kontrollit. Në këtë kuadër, dobësitë në monitorim, raportim dhe koordinim mund të prodhojnë jo vetëm pasoja financiare dhe administrative, por edhe ndikim negativ në besueshmërinë institucionale dhe në kapacitetin e MTKS për të administruar në mënyrë efektive projektet e financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorët.

10.4.3 Masa të propozuara

MTKS do të realizojë vlerësim periodik dhe vjetor të nevojave të institucioneve të varësisë për mbështetje me projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, programet IPA dhe donatorët ndërkombëtarë, me qëllim identifikimin e prioritetëve strategjike, nevojave institucionale dhe kapaciteteve ekzistuese administrative e teknike. Në këtë kuadër, do të hartohen raporte vjetore analitike për prioritizimin e projekteve dhe orientimin më të koordinuar të aplikimeve për financim. Përpara paraqitjes së projekt-propozimeve pranë donatorëve, do të kërkohet dakordësim paraprak ndërmjet MTKS dhe institucioneve të varësisë, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me prioritetet sektoriale, shmangia e mbivendosjeve ndërmjet projekteve dhe rritja e koherencës së dokumenteve aplikuese. Kjo masë synon gjithashtu të reduktojë riskun e fragmentimit institucional dhe të aplikimeve të pakonsoliduara. Do të krijohet dhe mirëmbahen sisteme të strukturuar të administrimit dhe dokumentimit të projekteve, përfshirë baza të dhënash elektronike për projektet, donatorët, kontratat, afatet, komponentët financiarë, raportimet periodike dhe statusin e zbatimit të secilit projekt. Këto sisteme do të shërbejnë për rritjen e gjurmueshmërisë administrative, kontrollit të brendshëm dhe monitorimit institucional të fondeve të financuara nga BE dhe donatorët e tjerë.

Gjithashtu, do të formalizohen mekanizma të rregullt koordinimi ndërinstytucional, përmes organizimit të takimeve periodike teknike dhe administrative ndërmjet MTKS, institucioneve të varësisë dhe strukturave përgjegjëse për menaxhimin e projekteve IPA dhe fondeve të donatorëve. Në këtë kuadër, do të hartohet dhe miratohet një metodologji/manual i standardizuar për raportimin periodik, monitorimin e indikatorëve të performancës dhe administrimin e dokumentacionit të projekteve. Për të reduktuar riskun operacional dhe administrativ, MTKS do të punojë për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe administrative të strukturave përgjegjëse për projektet BE/IPA, përmes plotësimit të vakancave, rishikimit të shpërndarjes së funksioneve, shmangies së mbivendosjeve administrative dhe organizimit të trajnimeve të specializuara për stafin mbi procedurat e BE-së, menaxhimin financiar, raportimin dhe auditimin e projekteve. Në të njëjtën kohë, do të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm, dokumentimit dhe auditueshmërisë së proceseve, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kërkesat e donatorëve, rritjen e transparencës institucionale dhe minimizimin e riskut të korrigjimeve financiare, vonesave në zbatim apo problematikave në raportim dhe monitorim.

10.5 PROKURIMET – DREJTORIA E PROKURIMEVE

10.5.1 Qëllimi dhe fusha

Qëllimi i këtij seksioni është forcimi i integritetit institucional në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrimit, nëpërmjet parandalimit të korrupsionit, reduktimit të risqeve të konfliktit të interesit, rritjes së transparencës dhe garantimit të përdorimit të ligjshëm, ekonomik dhe eficient të fondeve publike të administruara nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Në të njëjtën kohë, synohet forcimi i kulturës së llogaridhënies, respektimit të standardeve të etikës publike dhe gjurmueshmërisë së proceseve vendimmarrëse në të gjitha fazat e ciklit të prokurimit dhe administrimit të kontratave publike. Ky seksion synon gjithashtu të adresojë risqet që lidhen me planifikimin jo të saktë të nevojave, hartimin e specifikimeve teknike jo objektive ose kufizuese, mungesën e konkurrencës efektive, ndikimet e papërshtatshme në vendimmarrje, si dhe problematikat që mund të shfaqen gjatë monitorimit dhe zbatimit të kontratave publike. Përmes masave të integritetit synohet të garantohet që procedurat e prokurimit dhe konkurrimit të zhvillohen mbi bazën e parimeve të barazisë, konkurrencës së ndershme, proporcionalitetit dhe transparencës. Fusha e zbatimit nuk kufizohet vetëm në Drejtorinë e Prokurimeve, por përfshin të gjitha strukturat e MTKS dhe institucionet e varësisë që marrin pjesë në proceset e planifikimit të nevojave, hartimit të termave të referencës dhe specifikimeve teknike, administrimit të procedurave të prokurimit, vlerësimit të ofertave, ndjekjes së kontratave, monitorimit të zbatimit dhe raportimit financiar e administrativ. Në këtë kuadër, integriteti trajtohet si përgjegjësi e përbashkët institucionale dhe jo vetëm si funksion i strukturave të prokurimit publik.

10.5.2 Risqet kryesore

Një nga risqet kryesore në fushën e prokurimeve publike dhe procedurave të konkurrimit lidhet me konfliktin e interesit të stafit të përfshirë në fazat e planifikimit, hartimit të dokumenteve të tenderit, vlerësimit të ofertave, monitorimit të kontratave dhe marrjes së vendimeve administrative. Ky risk bëhet më i lartë në rastet kur nuk ekzistojnë mekanizma efektivë deklarimi, kontrolli dhe menaxhimi të konfliktit të interesit, ose kur vendimmarrja nuk shoqërohet me dokumentim të plotë dhe gjurmueshmëri administrative. Një tjetër risk lidhet me devijimin ose orientimin jo objektiv të specifikimeve teknike, kriterëve të kualifikimit dhe metodologjive të vlerësimit, veçanërisht në rastet kur këto dokumente hartohen pa argumentim të mjaftueshëm teknik dhe pa analiza të dokumentuara të nevojave reale të institucionit. Kjo mund të krijojë kufizim artificial të konkurrencës, favorizim të operatorëve të caktuar ekonomikë ose përdorim joefektiv të fondeve publike. Risk i rëndësishëm mbetet edhe mungesa e dokumentimit të plotë administrativ dhe dobësitë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm gjatë gjithë ciklit të prokurimit dhe administrimit të kontratave. Në mungesë të standardeve të qarta dokumentimi dhe monitorimi, krijohen hapësira për ndërhyrje të pajustificuara, ndryshime jo të argumentuara në procedura, mosgjurmueshmëri të vendimmarrjes dhe vështirësi në auditimin e proceseve. Gjithashtu, në kushtet e një ministrie të re, ekziston risk operacional dhe administrativ që lidhet me nivelin e ndryshëm të kapaciteteve profesionale ndërmjet strukturave, mungesën e praktikave të unifikuara administrative dhe nevojën për harmonizimin e procedurave të punës. Stafi i patrajnuar ose mungesa e njohurive të mjaftueshme mbi legjislacionin e prokurimit publik, menaxhimin e kontratave dhe standardet e kontrollit financiar mund të sjellë gabime procedurale, vonesa administrative, problematika në zbatim dhe rritje të riskut të parregullsive. Një tjetër aspekt problematik lidhet me monitorimin e zbatimit të kontratave publike, ku ekziston rreziku i mosndjekjes së detyrimeve kontraktore, pranimit të punimeve ose shërbimeve pa verifikim të plotë teknik dhe mungesës së koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për prokurimin, ndjekjen teknike dhe administrimin financiar. Këto situata mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimeve, eficiencën e përdorimit të fondeve publike dhe besueshmërinë e proceseve të prokurimit në institucion.

10.5.3 Masat operacionale

MTKS do të forcojë planifikimin vjetor mbi nevoja reale dhe buxhet të miratuar, me dokumentim të plotë dhe miratime të qarta. Zhvillimi i procedurave do të bëhet me zbatim strikt të afateve, përdorim kriteresh objektive dhe argumentim teknik e ligjor, si dhe ndarje të qartë përgjegjësish: kush harton dokumentet, kush vlerëson, kush ndjek, kush monitoron. Menaxhimi i konfliktit të interesit do të realizohet me deklaram të detyrueshëm dhe përjashtim nga procesi kur identifikohet konflikti. Transparenca do të rritet përmes publikimit në sistemet elektronike dhe trajtimit të ankesave në mënyrë të paanshme. Kontrolli i brendshëm do të forcohet me kontrole periodike dhe raportim tek drejtuesit, si dhe bashkëpunim me auditimin.

10.6 RINIA – PROGRAMET, FINANCIMET, PJESËMARRJA, BASHKËPUNIMI

10.6.1 Konteksti

Fusha e rinisë përbën një nga përgjegjësitë funksionale të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe përfshin hartimin dhe zbatimin e politikave rinore, programeve mbështetëse, projekteve edukative dhe sociale, si dhe koordinimin e bashkëpunimit me organizatat rinore, institucionet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët. Kjo fushë lidhet drejtpërdrejt me promovimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe publike, mbështetjen e iniciativave rinore dhe forcimin e mekanizmave të përfshirjes dhe përfaqësimit. Në praktikë, administrimi i programeve dhe financimeve për rininë përfshin procedura të konkurrencës për projekte, thirrje publike për organizata rinore, shpërndarje fondesh, përzgjedhje pjesëmarrësish dhe përfaqësuesish në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunim me aktorë të shumtë institucionalë dhe jofitimprurës. Për shkak të ndërveprimit të lartë me subjektet përfituese dhe natyrës së proceseve të përzgjedhjes dhe financimit, kjo fushë paraqet risk të shtuar integriteti dhe kërkon mekanizma të fortë transparence, dokumentimi dhe kontrolli administrativ. Risku i integritetit në sektorin e rinisë lidhet jo vetëm me administrimin e fondeve publike dhe donatore, por edhe me garantimin e barazisë në akses, objektivitetin në përzgjedhje, shmangies së favorizimeve dhe sigurimit të përfaqësimit të drejtë dhe transparent të të rinjve dhe organizatave rinore në programet dhe aktivitetet mbështetëse. Gjithashtu, kompleksiteti i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe me partnerët e jashtëm krijon nevojë për koordinim të vazhdueshëm, standardizim të procedurave dhe forcim të kapaciteteve administrative në menaxhimin e programeve rinore.

10.6.2 Risqet kryesore

Një nga risqet kryesore në fushën e rinisë lidhet me përzgjedhjen jo objektive ose jo të paanshme të projekteve, organizatave rinore, aktiviteteve apo përfituesve të mbështetjes financiare dhe institucionale. Ky risk bëhet më i lartë në rastet kur mungojnë kritere të standardizuara dhe të publikuara paraprakisht, procedura të dokumentuara vlerësimi, mekanizma transparentë pikëzimi dhe komisione të formalizuara me përgjegjësi të qarta administrative. Në mungesë të këtyre elementeve, krijohen perceptime për favorizim, trajtim të pabarabartë ose ndikime të papërshtatshme në vendimmarrje, duke cenuar besueshmërinë e proceseve dhe të institucioneve përgjegjëse. Një tjetër risk lidhet me monitorimin dhe verifikimin e dobët të zbatimit të projekteve dhe përdorimit të fondeve publike ose donatore. Në raste të tilla, fondet mund të përdoren pa arritur objektivat dhe rezultatet e parashikuara, ndërsa raportimi financiar dhe narrativ mund të mbetet formal dhe jo i mbështetur në indikatorë konkretë të performancës. Mungesa e monitorimit periodik, verifikimeve në terren dhe dokumentimit të rezultateve rrit riskun e përdorimit joefektiv të fondeve dhe të uljes së ndikimit real të programeve rinore.

Risk integriteti paraqet gjithashtu procesi i përzgjedhjes së të rinjve dhe përfaqësuesve në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, forume rinore, programe shkëmbimi apo iniciativa të mbështetura nga donatorët. Në mungesë të procedurave transparente, kritereve të qarta të përzgjedhjes dhe publikimit të rezultateve, krijohen perceptime për mungesë barazie në akses dhe favorizim të individëve ose organizatave të caktuara. Një aspekt tjetër problematik lidhet me nivelin e ndryshëm të kapaciteteve administrative dhe organizative të organizatave rinore përfituese, çka mund të sjellë vështirësi në administrimin korrekt të fondeve, respektimin e procedurave të raportimit dhe realizimin e aktiviteteve sipas standardeve të kërkuara. Në të njëjtën kohë, mungesa e koordinimit të qëndrueshëm ndërinstitucional dhe e sistemeve të unifikuara të dokumentimit dhe monitorimit mund të krijojë mbivendosje aktiviteteve, paqartësi në përgjegjësi dhe vështirësi në vlerësimin e ndikimit real të politikave dhe programeve rinore. Gjithashtu, ekziston risku që proceset e konsultimit dhe pjesëmarrjes rinore të mbeten formale dhe jo përfaqësuese, duke kufizuar përfshirjen reale të të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave që i prekin drejtpërdrejt. Kjo mund të ndikojë negativisht në besimin e të rinjve ndaj institucioneve publike dhe në efektivitetin e mekanizmave të pjesëmarrjes dhe dialogut rinor.

10.6.3 Masat parandaluese

MTKS do të standardizojë procedurat e thirrjeve publike, kriteret e financimit dhe proceset e vlerësimit për projektet dhe programet rinore, me qëllim garantimin e transparencës, objektivitetit dhe trajtimit të barabartë të të gjithë aplikantëve. Në këtë kuadër, do të publikohen paraprakisht kriteret e përzgjedhjes, metodologjia e vlerësimit, afatet procedurale dhe rezultatet përfundimtare të proceseve të konkurrimit, duke siguruar gjurmueshmëri dhe dokumentim të plotë të vendimmarrjes administrative. Për të reduktuar riskun e favorizimeve dhe mungesës së objektivitetit, proceset e vlerësimit do të mbështeten në komisione të formalizuara, me përgjegjësi të qarta dhe dokumentim të procesit të pikëzimit dhe vlerësimit të aplikimeve. Gjithashtu, do të forcohen mekanizmat për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit për personat e përfshirë në procedurat e shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

MTKS do të ndërtojë dhe zbatojë mekanizma të strukturuar monitorimi dhe verifikimi të zbatimit të projekteve dhe përdorimit të fondeve, përmes raportimeve periodike, kontroleve të dokumentacionit administrativ dhe financiar, verifikimeve të aktiviteteve të realizuara dhe evidentimit të rezultateve konkrete të projekteve. Monitorimi do të fokusohet jo vetëm në aspektin formal të raportimit financiar, por edhe në vlerësimin e ndikimit dhe arritjes së objektivave të programeve rinore. Në të njëjtën kohë, do të zhvillohen standarde më të qarta për administrimin e dokumentacionit, arkivimin elektronik dhe gjurmueshmërinë e proceseve të financimit dhe monitorimit, me qëllim rritjen e kontrollit administrativ dhe auditueshmërisë së programeve.

Për proceset e pjesëmarrjes rinore dhe përfaqësimit në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, MTKS do të rrisë transparencën e procedurave të përzgjedhjes, përmes publikimit të kritereve, procedurave dhe rezultateve të përzgjedhjes, si dhe dokumentimit të procesit vendimmarrës. Gjithashtu, do të forcohen mekanizmat e konsultimit dhe dialogut me organizatat rinore, grupet e interesit dhe të rinjtë, me synim garantimin e përfshirjes, barazisë dhe përfaqësimit sa më të gjerë në hartimin dhe zbatimin e politikave rinore. Për të rritur integritetin institucional në këtë sektor, MTKS do të investojë gjithashtu në forcimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të stafit dhe strukturave përgjegjëse për programet rinore, përmes trajnimeve mbi menaxhimin e fondeve, procedurat administrative, monitorimin e projekteve dhe standardet e transparencës dhe etikës publike.

11. MASA PARANDALUESE DHE KORRIGJUESE

Plani i masave të MTKS ndërtohet mbi parimin se integriteti institucional nuk garantohet vetëm përmes kuadrit ligjor dhe deklarimeve formale, por kërkon procese të qarta administrative, mekanizma efektivë kontrolli të brendshëm, transparencë në vendimmarrje, gjurmueshmëri të proceseve dhe përgjegjësi individuale në ushtrimin e funksioneve publike. Në këtë kuadër, masat e parashikuara synojnë forcimin e kulturës së integritetit në të gjitha strukturat e ministrisë dhe institucioneve të varësisë, duke reduktuar hapësirat për konflikt interesi, favorizim, mungesë transparence dhe përdorim joefektiv të burimeve publike. Për këtë arsye, fokusi kryesor do të vendoset në standardizimin e procedurave më të ndjeshme administrative dhe financiare, rritjen e dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së proceseve vendimmarrëse, forcimin e rolit të kontrollit të brendshëm dhe auditimit, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe etike të stafit. Gjithashtu, do të promovohet përdorimi i sistemeve të digjitalizuara të dokumentimit dhe raportimit, me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e riskut të manipulimit ose ndërhyrjeve të pajustificuara. Në mënyrë të veçantë, në sektorët ku MTKS ndërvepron ngushtësisht me subjekte private, organizata, federata, operatorë ekonomikë apo partnerë të jashtëm, do të forcohet dokumentimi i komunikimeve zyrtare, argumentimi administrativ i vendimmarrjes dhe kontrolli mbi proceset e shqyrtimit dhe miratimit. Kjo synon reduktimin e riskut të ndikimeve të papërshtatshme dhe rritjen e besueshmërisë institucionale në marrëdhëniet me palët e interesuara.

Në proceset e financimit, granteve, programeve rinore dhe aktiviteteve sportive, masat do të fokusohen në rritjen e transparencës së kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes, publikimin e rezultateve, dokumentimin e procesit të vlerësimit dhe forcimin e monitorimit të zbatimit të projekteve dhe përdorimit të fondeve publike. Në sektorin e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, prioritet do të kenë digjitalizimi, inventarizimi, katalogimi elektronik, mbikëqyrja profesionale dhe forcimi i standardeve të sigurisë dhe administrimit të pasurive kulturore.

Në fushën e prokurimeve publike dhe administrimit të kontratave, fokusi do të jetë ndarja e qartë e përgjegjësi, standardizimi i procedurave, forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe rritja e auditueshmërisë së proceseve, me synim garantimin e konkurrencës së ndershme, përdorimit eficient të fondeve publike dhe respektimit të standardeve të integritetit institucional.

12. STRUKTURA E MONITORIMIT, RAPORTIMIT DHE PËRDITËSIMIT

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit do të koordinohet nga drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore në MTKS, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, drejtuesit e drejtorive përgjegjëse, strukturat administrative të ministrisë dhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore do të ketë rol koordinues në ndjekjen e zbatimit të masave, mbledhjen e informacionit, administrimin e raportimeve periodike dhe monitorimin e progresit të planit në nivel institucional. Çdo drejtori përgjegjëse dhe institucion në varësi do të raportojë periodikisht mbi masat që i takojnë, duke paraqitur dokumentacion dhe prova konkrete të zbatimit, përfshirë udhëzime administrative, publikime, raporte monitorimi, dokumente trajnimi, procesverbale takimesh, evidenca të aktiviteteve dhe materiale të tjera mbështetëse që lidhen me masat e integritetit.

Raportimi periodik mbi zbatimin e planit do të realizohet minimalisht një herë në vit, ndërsa për masat me afate afatshkurtra ose me risk më të lartë do të kërkohen raporte ndërmjetëse dhe ndjekje më e shpeshtë administrative. Informacioni i mbledhur do të përdoret për të vlerësuar nivelin e realizimit të masave, problematikat e hasura në zbatim dhe nevojat për përmirësim të procedurave apo mekanizmave të kontrollit. Duke marrë në konsideratë se MTKS është një strukturë institucionale e re dhe në proces konsolidimi administrativ dhe funksional, Plani i Integritetit do të rishikohet dhe përditësohet periodikisht, në përputhje me zhvillimet organizative, ndryshimet procedurale, risqet e identifikuar dhe nevojat e reja institucionale që mund të evidentohen gjatë zbatimit të tij.

13. ANEKS – PLAN MASASH

Për zbatimin efektiv të Planit të Integritetit, MTKS do të ndërmarrë një sërë masash administrative, organizative dhe monitoruese, të orientuara drejt forcimit të transparencës, standardizimit të proceseve, rritjes së gjurmueshmërisë së vendimmarrjes dhe reduktimit të risqeve të integritetit në sektorët me ndjeshmëri më të lartë institucionale. Masat e propozuara mbulojnë fusha të ndryshme të veprimtarisë së ministrisë, përfshirë proceset rregullatore, konsultimin publik, menaxhimin e trashëgimisë kulturore, projektet BE/IPA, sportin, rininë, prokurimet publike dhe administrimin e fondeve publike. Në këtë kuadër, masat synojnë jo vetëm përmirësimin e procedurave të brendshme dhe forcimin e kontrollit administrativ, por edhe zhvillimin e kulturës institucionale të integritetit përmes trajnimeve, standardizimit të praktikave të punës dhe forcimit të mekanizmave të raportimit dhe monitorimit. Njëkohësisht, do të promovohet përdorimi i sistemeve të digjitalizuara, publikimi periodik i informacionit dhe krijimi i mekanizmave të sinjalizimit dhe kontrollit, me qëllim rritjen e besueshmërisë publike dhe garantimin e përdorimit të ligjshëm dhe

eficient të burimeve publike. Për secilën masë janë përcaktuar afatet orientuese të realizimit, strukturat përgjegjëse dhe indikatorët kryesorë të monitorimit, me qëllim mundësimin e ndjekjes periodike të progresit dhe vlerësimit të nivelit të zbatimit të planit.

Nr	Masa (përmbledhje)	Afati	Përgjegjës	Indikator
1	Manual i brendshëm i vendimmarrjes dhe komisioneve (konflikt interesi, dokumentim)	6 muaj	SP/Drejtoria Rregullatore dhe e Përputhshmërisë /BNJ	Manual i miratuar
2	Standardizim konsultimi publik (publikim, komente, përgjigje)	6 muaj	Drejtoria Rregullatore dhe e Përputhshmërisë + Linja	Raport vjetor konsultimi
3	Model monitorimi për Marrëveshjet e Zhvillimit (turizëm)	6 muaj + vazhdim	Standarde Turizmi	Raporte periodike
4	Procedura alternative të dokumentuara kur bien sistemet online	3 muaj	AKSHI + MTKS	Procedurë e miratuar
5	Digjitalizim/inventarizim i trashëgimisë kulturore dhe muzeve	12-24 muaj	Strukturat Trashëgimia Kulturore /Muzetë dhe institucionet e trashëgimisë kulturore të varësisë	Regjistra digjitalë
6	Publikim periodik raporte financiare/monitorimi (kulturë/sport/rini)	në vazhdim	Drejtoria të përkatëse	Raporte të publikuara
7	Protokoll për përzgjedhje dhe transparencë në sport (regjistra, kritere)	6 muaj	Drejtoria e Sportit	Protokoll i miratuar
8	Mekanizëm sinjalizimi për parregullsi (sport/rini/kulturë)	3 muaj	MTKS	Kanal funksional
9	Manual raportimi për projekte BE/IPA + databazë	6 muaj	DPAK/Projekte	Manual + databazë
10	Trajnime periodike: etikë, konflikt interesi, informim, prokurim	vjetor	BNJ + Drejtoria Rregullatore dhe e Përputhshmërisë + Drejtoria e Prokurimeve	Nr. trajnimesh